



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHSËM

VENDIM

Nr.19, datë 21.12.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME (LAVAZHO), TË SUBJEKTIT “J.A.M CONSTRUCTIONS” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, RRUGA LIMAN KABA, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50,të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “J.A.M Constructions” sh.p.k, “Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme (sanitare), me vendndodhje, rruga Liman Kaba, bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

-X=483984; Y=4575274; Z=121 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=0.5 l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 250 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 200 m

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSII)

-X=483990; Y=4575275; Z=121 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

-X=483975; Y=4575325; Z=120 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

